# MODELET E EDUKIMIT NË SEKTORIN PUBLIK TË VËNA NË ZBATIM NË VENDE TË NDRYSHME: RASTI STUDIMOR I AFRIKËS SË JUGUT

Prezanton: Trudy Paul

SAICA
THE SOUTH AFRICAN INSTITUTE OF CHARTERED ACCOUNTANTS
develop.influence.lead.

P

## Përmbajtja e prezantimit

1. Prezantim i Institutit të Kontabilistëve të Miratuar të Afrikës së Jugut (SAICA)
2. Informacion i përgjithshëm mbi sektorin publik
3. Sistemi arsimor në Afrikën e Jugut
4. Partneriteti midis SAICA-s dhe dikastereve
5. Teknikët kontabël në dikastere
6. Teknikët kontabël në sektorin publik: Kuadri i kompetencave
7. Kualifikimet
8. Akreditimi: Ofruesit e arsimit dhe punëdhënësit
9. Sukseset
10. Mësimet e nxjerra

SAIC

01 **Nivel i udhëheqjes strategjike**

CA(SA)
CHARTERED ACCOUNTANT
SOUTH AFRICA

02 **Nivel i mesëm drejtues**

Associate
General
Accountant (SA)

Nive
li
fille
star
/
nive
li
bazë

03 **Niveli fillestar / niveli bazë**

- SAICA, një prej instituteve më kryesore të kontabilitetit në botë, ofron tre tituj me emër të mirë dhe të rregulluar, për t'iu përshattur çdo niveli aftësive – **CA(SA), AGA(SA) and AT(SA)**.

- Nga një nivel bazë deri në një nivel strategjik të aftësisë kontabël dhe tregtare, ka një titull të besueshëm nga SAICA për të fuqizuar çdo ekip finance.

- Partneritet me sektorin publik për nisma të ngritjes së kapaciteteve të cilat çojnë profesionistë të aftë kontabël në të gjitha nivelet përmes arsimimit dhe përvojës së drejtpërdrejtë në punë

## Sektori publik i Afrikës së Jugut

- Viti 1994 shënoi një ndryshim të rëndësishëm për vendin
- Në të njëjtën kohë, pati ndryshime në sektorin publik
- Mandati i sektorit publik u zgjerua për të përfshirë rritjen ekonomike, mbarështimin e burimeve, arsimin e barabartë, kujdesin shëndetësor, zhvillimin e infrastrukturës, të drejtë strehimi të barabartë
- Edhe sot ka vështirësi lidhur me sigurinë, arsimin, zhvillimin e infrastrukturës dhe kujdesin shëndetësor
- Arsimi i barabartë, një fushë në qendër të vëmendjes
- Profesionalizimi i sektorit publik Kontabiliteti dhe më gjerë shërbimet financiare



# Sektori publik i Afrikës së Jugut




- Tri janë sferat kryesore të qeverisjes:
  - ✓ Qeveria kombëtare
    *Thesari, bujqësia, mbrojtja*
  - ✓ Qeveritë provinciale
    *9 provinca: Rrugët & transporti, shërbimet policore, strehimi*
  - ✓ Qeverisja vendore
    *278 bashki: Ujësjellësi, kanalizimet, mbrojtja nga zjarri*

- Drejtoritë e kontabilitetit dhe financës janë ngritur në të gjitha sferat e qeverisjes

# Sektori publik: struktura e drejtorive të kontabilitetit dhe financës

Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit

Kontabiliteti financiar

Kontabiliteti i drejtimit

Niveli A: Nëpunës kontabël

Niveli B: Kontabilist i ulët

Niveli C: Kontabilist shtetëror

Niveli D: Kontabilist i përgjithshëm

Niveli E: Kontabilist i lartë



# Sektori publik: Drejtoritë e kontabilitetit dhe financës

- Struktura të krijuara për të ndihmuar ngritjen e kapaciteteve në nivel individual, institucional, provincial dhe kombëtar
- Standardizimi i strukturës nga Thesari Kombëtar dhe Departamenti i Administratës së Shërbimit Publik (DPSA)
- Shtyllat individuale për çdo fushë specializimi: Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit, kontabiliteti financiar, kontabiliteti i drejtimit,
- Nivel të ndryshme brenda secilës fushë specializimi (nivelet A-E): Nëpunës llogarie, kontabilist i ulët, kontabilist shtetëror, kontabilist i përgjithshëm, kontabilist i lartë
- Aftësitë përshkruhen me hollësi sipas specializimit dhe sipas nivelit në Fjalorin e Aftësive Teknike të Thesarit Kombëtar (TCD)
- Standardet e vendeve të punës dhe profilet e punës lidhen me TCD-në e krijuar
- Kuadri i Aftësive për Teknikët Kontabël të SAICA-s i jep përgjigje nevojës për zhvillim të aftësive në disiplinat e kontabilitetit financiar dhe kontabilitetit të drejtimit dhe në nivelet 1-3: nëpunës llogarie, kontabilist i ulët, kontabilist shtetëror

# Sistemi arsimor

- Brenda sistemit arsimor të Afrikës së Jugut, ekziston Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (NQF)
- NQF është një kornizë unike kombëtare e integruar e mësimit
- Programet e kualifikimeve dhe aftësimit regjistrohen në NQF në nivelet 1-9.

  *1 = arsimi elementar për të rritur & 10 = doktoraturë*
- Autoriteti Afrikanojugor i Kualifikimeve (SAQA) është kujdestar i NQF-së
- SAQA mbikëqyr regjistrimin e kualifikimeve dhe bashkëpunon me 3 këshilla të cilësisë që janë ngritur

**Arsimi i lartë**

QCHE

Këshilli i Cilësisë për Arsimin e Lartë

NQF – nivelet 5-10

**Arsimi i mëtejshëm**

QCTO

Këshilli i Cilësisë për Zejet dhe Profesionet

NQF – nivelet 3-8

**Arsimi fillor**

Umalusi

Këshilli i Cilësisë për Arsimin Fillor (Shkollat)

NQF – nivelet 1-4

# Kuadri i Aftësive të Teknikëve Kontabël i SAICA-s

Kuadri i aftësive identifikon dhe përshkruan aftësitë profesionale (vlerat dhe qëndrimet profesionale, aftësitë mundësuese dhe aftësitë teknike) të cilat një teknik kontabël i sektorit publik PSAT(SA) duhet t'i dëshmojë në hyrje të profesionit.

Shërben si pikë referimi për PSAT(SA) ekzistues dhe të ardhshëm, punëdhënësit dhe publiku i gjerë, duke mundësuar kështu një njohuri të qartë për aftësitë bazë profesionale që duhet të zotërojë tekniku kontabël kur fillon karrierën.

Kuadri i aftësive është i harmonizuar me Fjalorin e Aftësive Teknike (TCD) të Thesarit Kombëtar për rolet në nivelet A-C

Kuadri i aftësive siguron edhe bazën mbi të cilën zhvillohen dhe realizohen kualifikimet dhe programet e përvojës në punë për kontabilistët e sektorit publik në nivelin hyrës deri në nivelin e mesëm.

## Kuadri i Aftësive të Teknikëve Kontabël i SAICA-s (vijon 2)

**Parimet themelore që orientojnë zhvillimin e Kuadrit të Aftësive për Teknikët kontabël në sektorin publik janë:**

1. Ecuria në punë
2. Sjellja teknike & administrimi
3. Kompetenca profesionale



# Kuadri i Aftësive të Teknikëve Kontabël i SAICA-s (vijon 3)

**Vlerat dhe qëndrimet profesionale**

Etika
Të mësuarit gjatë gjithë jetës
Profesionalizmi

**Aftësitë mundësuese**

Komunikimi

Vendimmarrja

Shprehitë digjitale

Përmbushja e nevojave të klientëve
Menaxhimi i vetes dhe puna në grup / shprehitë

**Aftësitë teknike**

Të përshtatura për sektoin publik

# Kuadri i Aftësive të Teknikëve Kontabël i SAICA-s (vijon 4)

**Aftësitë teknike**

Digjitalizimi në mbështetje të proceseve kontabël

Regjistrimi dhe përpunimi i veprimeve financiare

Përgatit dhe regjistorn veprimet e shitjes dhe të ardhurave

Përgatit dhe regjistron blerjet dhe pagesat

Administron debitorët

Mban llogarinë arkë

Njehson, mbyll në fund të muajit dhe përgatit bilancin vërtetues

Harton, analizon dhe interpreton pasqyrat financiare

Kontabilizon aktivet afatgjata materiale, pagat dhe tatim-taksat

Administron likuiditetin, aktivet dhe inventarin

Buxhetimi dhe kostimi

TVSH

Tatime të biznesit & tatime personale

Sistemi i kontrollit të brendshëm

# PËRMBAJTJA E KUALIFIKIMIT:
# KUALIFIKIMI KONTABILITETI I SEKTORIT PUBLIK

**Certifikata: Teknik Kontabël në Sektorin Publik**
**NQF – Niveli 3**
**1 vit (120 kredite)**

- Hyrje në kontabilitet
- Shprehitë në punë
- Puna me kompjuter
- Etika profesionale
- Buxhetimi dhe raportimi
- Kryerja dhe regjistrimi i pagesave
- Kontabilizimi i të ardhurave dhe arkëtimeve

**Certifikata FET:**
**Teknik Kontabël në Sektorin Publik**
**NQF – Niveli 4**
**1 vit (120 kredite)**

- Komunikimi dhe mbikëqyrja
- Përdorimi i teknologjisë në kontabilitet
- Etika profesionale
- Përgatitja i rakordimeve dhe bilanceve vërtetuese
- Pasqyrat Financiare
- Rimarrja e debitorëve
- Përgatitja dhe monitorimi i buxhetit

**Certifikata: Kontabiliteti i sektorit publik**
**NQF – Niveli 5**
**1 vit (120 kredite)**

- Komunikimi dhe drejtimi i ekipit
- Formati i raportimit ekonomik dhe klasifikimi SCOA
- Etika profesionale
- Administrimi i buxhetit
- Kontabilizimi i aktiveve dhe inventarit
- Raportimi financiar
- Sistemi i kontrollit të brendshëm, auditimi i brendshëm dhe auditimi i jashtëm

## QASJA E VLERËSIMIT MBËSHTETUR NË AFTËSITË

- ✓ Studentët dëshmojnë aftësinë për t'i përdorur dijet dhe aftësitë e fituara gjatë formimit.
- ✓ Vlerësimet matin përmirësimin e nxënësit, ndjekin ecurinë gjatë kualifikimit dhe vlerësojnë gatishmërinë për të punuar në tregun e punës.
- ✓ Vlerësimi përfundimtar është ndërthurje e simulimeve të kryera në fund të çdo njësie.
- ✓ Strategjia e vlerësimit përqendrohet në vlerësimet formuese dhe vlerësimet kundrejt një standardi.
- ✓ Vlerësimet formuese lidhen me programin mësimor, ndërsa vlerësimet kundrejt standardit përdoren për ta vlerësuar arritjen kundrejt rezultateve të kualifikimit në përfundim të programit.
- ✓ Vlerësimi kërkon të kuptojnë sa mund të dëshmojë nxënësi se i ka zotëruar aftësitë.

# Rruga drejt anëtarësimit: Si të bëhesh anëtar i SAICA-s me titullin PSAT(SA)

**MEMBERSHIP MODEL**

1. **SP: Certificatë e Teknikut Kontabël (NQF niveli 3)**
2. **SP: FET Certifikata e Teknikut Kontabël (NQF – Niveli 4)**
3. **SP: Certificatë [illegible] kontabilitet (NQF niveli 5)**
4. **Testi i Aftësisë profesionale**
5. **Member PS Accounting Technician South Africa PSAT(SA)**

**12 MUAJ PËRVOJË TË ORIENTUAR NË PUNË**

*Njohja e mësimit dhe përvojës në punë të fituar përmes institucioneve të tjera veç SAICA-s dhe qendrave jo të akredituara në punës është e mundshme me anë të procesit të anëtarësimit*

## AKREDITIMI

- ✓ **SAICA është**
  - ❖ e regjistruar pranë SAQA-s si organ profesioni dhe është partner i kontrollit të cilësisë për QCTO-në
  - ❖ autoritet i deleguar nga rregullatori për të akredituar ofruesit e arsimit për realizimin e kualifikimeve të teknikut kontabël dhe punëdhënësit për të ofruar përvojën e orientuar në punë
- ✓ **Ofruesit e ardhshëm të formimit dhe punëdhënësit vlerësohen kundrejt:**
  - ❖ Burimeve, sistemeve, ekspertizës
- ✓ **Kërkohet angazhim për**
  - ❖ Kryerjen e realizimit të mësimit,
  - ❖ Kryerjen e vlerësimit
  - ❖ Dhënien e mundësive për përvojë në punë

## PROCESI I KONTROLLIT TË CILËSISË

- ✓ **Pyetësor vetëvlerësimi** U jep mundësi ofruesve të formimit të shqyrtojnë dhe vlerësojnë punën e tyre kundrejt standardeve të kërkuara nga AT(SA);
- ✓ **Vizita të jashtme të verifikimit në vend** Bëhet çdo vit, ofruesit e formimit maten kundrejt kritereve të akreditimit dhe u lejohet ta mbajnë akreditimin nëse janë respektuar të gjithë standardet e cilësisë. Në rastet kur konstatohet se ofruesit e formimit nuk i respektojnë këto kritere, miratohet një plan ndreqjeje, mund të vendosen sanksione ose mund të revokohet akreditimi, në varësi se sa i rëndë është mosrespektimi;
- ✓ **Monitorim-vlerësimi i mësimdhënies dhe nxënies** Bëhet vëzhgim në klasë për të matur cilësinë e mësimdhënies. Këtu mund të përfshihen intervista me nxënës dhe kontrolle në vend të dokumenteve përgatitore të lektorëve, si planet mësimore;
- ✓ **Kontrolle në vend të vlerësimit** Bëhen kontrolle në vend të vlerësimeve, pa dijeninë e ofruesit të formimit apo të nxënësit. Kjo kërkon të sigurojë ndjekjen e rreptë të rregullave të vlerësimit; dhe
- ✓ **Verifikimi i rezultateve** Një përqindje e të gjitha rezultateve të nxënësve verifikohet nga AT(SA)

për të siguruar njëtrajtshmërinë në vendosjen e notës;

**Angazhimi dhe rritja e aftësive** Zhvillohen me ofruesit e formimit dhe punëdhënësit seanca tremujore angazhimi dhe rritjesh të shprehive

# SUKSESET



- ✓ **Mbi 6000 nxënës:** Sipas vlerësimit të fundit në 2020, mbi 6000 nxënës i kishin përfunduar kualifikimet e kontabilitetit në sektorin publik pranë SAICA-s;



- ✓ **Kualifikime të përshtatshme për qëllimin: të cilat janë** zhvilluar në 2012, janë shqyrtuar, përmirësuar, harmonizuar me TCD-në dhe u janë ofruar nxënësve në mbarë vendin;



- ✓ **Bashkëpunim me financuesit**: Autoritetet e Arsimit dhe Formimit Sektorial (SETA), Fondi Kombëtar i Aftësive, Bashkimi Evropian



- ✓ **Punëdhënësit:** nxënësit në proces dhe të diplomuarit janë punësuar me sukses në dikastere lokale, provinciale dhe qendrore



- ✓ **Monitorimi dhe vlerësimi:** Është marrë feedback pozitiv gjatë procesit të monitorim-vlerësimit nga nxënësit, trupa mësimore, punëdhënësit, rregullatorët dhe ofruesit e arsimit.

# MËSIMET E NXJERRA

- ✓ **Zgjerimi i grupeve të palëve të interesit për konsultim:** Konsultimi me palët më kryesore të interesit ka shumë rëndësi për zhvillimin dhe realizimin e një kualifikimi të përshtatshëm me qëllimin;

- ✓ **Shmangia e mbështetjes së tepruar në vlerësimin kundrejt standardit:** mësimi me pjesëmarrje fizike në klasë, mësimi elektronik, vlerësimi formues dhe vlerësimi kolegjial janë pjesë e vyer e procesit të vlerësimit si në vlerësimin përfundimtar kundrejt standardit

- ✓ **Të mësuarit me përvojë:** Raste studimore dhe simulimet ndihmojnë në formimin e një nxënësi që është më i gatshëm për punën;

- ✓ **Zhvillimi i vazhduar profesional (ZHVP):** Nxënësit dhe personeli akademik që nuk merr pjesë sa duhet në ZHVP do të mbeten mbrapa shokëve.

- ✓ **Asnjë nxënës të mos lihet pas:** Përdoren strategji të ndryshme mësimore që nxënësit të mësojnë me hapin e tyre;

Faleminder it

SAICA
THE SOUTH AFRICAN INSTITUTE
OF CHARTERED ACCOUNTANTS

**NA KONTAKTONI**
17 Fricker Road, Illovo, Sandton, Johannesburg, 2196, South Africa
Private Bag X32, Northlands, 2116, Johannesburg, South Africa

Kontakti kryesor
**AT(SA): Trudy Paul**
Email: trudyp@saica.co.za

# Falemi nderit

develop.influence.lead.